



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

*Nr. 115, Datë 27.07.2017*

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR GARANCITË FINANCIARE TË  
PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; kapitullit III, pika III.2.4 të “Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin nr. 139, datë 15.08.2016 të Bordit të ERE-s; si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 27.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draft Rregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Rregullave për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike.”
- ERE me Vendimin nr. 3, datë 19.01.2017, filloi procedurat për miratimin e “Rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.
- ERE me shkresën nr. 90 Prot., në datë 26.01.2017, ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me “draft – Rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.”
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën me nr. 32/1 prot., datë 23.02.2017 dhe OSHEE sh.a. me shkresën nr. 2742/1 prot., datë 10.02.2017, kanë përcjellë në ERE

sugjerimet dhe komentet e tyre në lidhje me draft – *Rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “Rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.( Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., KESH sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetin e Konkurrencës, MEI dhe palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ANËTARI I BORDIT TË ERE**  
**Adriatik BEGO**



## **RREGULLAT PËR GARANCITË FINANCIARE TË PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE.**

### **Kapitulli I Dispozita të Përgjithshme**

#### **Neni 1 Autoriteti**

Këto rregulla hartohen dhe miratohen në zbatim të pikës III.2.4 të “Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, i ndryshuar.

#### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i këtyre rregullave është të përcaktojë procedurat për garancitë financiare që çdo pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike (TEE) duhet të sigurojë për llogari të OST për shërbimin e transmetimit përpara se të regjistrohet në TEE.

#### **Neni 3 Përcaktime dhe shkurtime**

- 1- ERE – Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror;
- 2- TEE – Tregu Shqiptar i Energjisë Elektrike - është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivatët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtëra, referuar Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;

3- OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, i licensuar nga ERE.

4- Operatori i Tregut - Struktura përgjegjëse e licensuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike që aktualisht është pjesë e OST-së.

5- Marrëveshje e pjesëmarrjes në treg - një dokument që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve që e nënshkruajnë atë, OST-OT dhe Pjesëmarrësit në Tregun e Energjisë Elektrike duke përcaktuar detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga veprimtaria e tyre në tregun e energjisë.

6- Pjesëmarrësi i tregut të energjisë elektrike - është një person juridik, i regjistruar si pjestarë i tregut të energjisë elektrike, që përfshinë prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Sistemet e mbyllura të Shpërndarjes dhe Operatori i Tregut, mbajtës të licensës të lëshuar nga ERE.

7 – Garanci financiare do të thotë një angazhim në një bankë për të mbuluar dhe siguruar përmbushjen në mënyrë të besueshme të detyrimeve financiare të pjesëmarrësit në treg ndaj OST.

## **Kapitulli 2**

### **Informacioni teknik dhe Garancia Fianciare për Rregjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike**

#### **Neni 4 Informacioni teknik**

1- Në mbështetje të Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Treg, çdo pjesëmarrës në Tregun e Energjisë Elektrike, do të ofrojë për Operatorin e Tregut informacionin teknik në vijim, në aneksin e kësaj rregullore.

2- Dokumentacioni, sipas rastit, është origjinal ose fotokopje e noterizuar.

- 3- Ky informacion është kusht për regjistrim në Tregun e Energjisë Elektrike.

## **Neni 5**

### **Depozitimi dhe përdorimi i garancisë financiare**

1. Çdo subjekt i regjistruar në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike (TEE) do të depozitojë në një bankë tregtare të krijuar në Shqipëri, një garanci financiare në lekë. Garancia financiare është një parakusht për pjesëmarrjen në TEE.
2. Pjesëmarrësi në TEE do të njoftojë OST për depozitimin e garancisë financiare jo më vonë se 15 ditë pune përpara se programi fizik i parashikuar nga pjesëmarrësi në TEE të bëhet efektiv, në mënyrë që të lejojë OST të verifikojë që garancia është vënë.
3. Një pjesëmarrës i TEE do të autorizojë OST që të përdorë sasinë e garancisë për pagesa ose transferta për OST-në pa miratimin paraprak të tij, përveçse kur pjesëmarrësi ka paraqitur brenda 7 ditëve pune nga njoftimi i OST-së për përdorimin e garancisë, një ankesë në ERE që arsyeton përse OST nuk duhet të përdorë garancinë.
4. OST do të njoftojë pjesëmarrësin 10 ditë pune më përpara për përdorimin e garancisë financiare, arsyen për përdorimin e saj (si p.sh. detyrimet e papaguara ndaj OST-së) si dhe për datën e ekzekutimit të garancisë financiare.
5. OST do ta përdorë garancinë financiare të një pjesëmarrësi të TEE-së për të përmbushur detyrimet që ky i fundit ka ndaj OST-së.
6. Shuma e garancisë financiare do të jetë e barabartë me 5% të programit fizik mujor të parashikuar nga pjesëmarrësi në TEE shumëzuar me 10 lekë/kWh, por jo më shumë se 20 milion lekë dhe jo më pak se 500 mijë lek, në përputhje dhe në plotësim të Rregullave të Tregut.
7. OST do të humbas të drejtën për të përdorur garancinë financiare të një pjesëmarrësi të TEE-së mbas njoftimit të ç' regjistrimit të pjesëmarrësit nga TEE, siç parashikohet në Rregulloren për procedurat e regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike.
8. Mbas njoftimit të ç' regjistrimit të pjesëmarrësit nga TEE, siç parashikohet në Rregulloren për procedurat e regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike, OST ka të drejtë të prekë nga garancia financiare atë pjesë që i korrespondon detyrimit financiar të prapambetur të pjesëmarrësit ndaj OST.
9. Çdo detyrim i prapambetur i pjesëmarrësit në TEE pasi ai është ç' regjistruar nga TEE, për të cilën OST ka prekur garancinë financiare siç përcaktohet në paragrafin më sipër në këtë pikë, mund të jetë objekt i kërkimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Neni 6**

### **Ankimi mbi përdorimin e garancisë financiare**

- 1 - Një pjesëmarrës që kundërshton përdorimin e garancisë financiare nga OST mund të paraqesë një ankesë në ERE brenda 7 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit të OST-së lidhur

me përdorimin e garancisë financiare duke vënë në dijeni edhe OST për ankesën e paraqitur në ERE.

2- Nëse një pjesëmarrës paraqet një ankesë sipas pikës 1 të këtij neni, OST nuk do ta përdorë garancinë deri kur të lejohet ta bëjë një gjë të tillë nga ERE ose mbas 30 ditëve pune nga paraqitja e ankesës nëse ERE nuk ka vepruar, brenda afateve kohore të përcaktuar në këto rregulla ERE do të marrë një vendim për ankesën e paraqitur i cili do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga OST.

3 - Vendimi i ERE-s mund të apelohej nga pjesëmarrësi në TEE ose OST në Gjykatën e administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga publikimi i Vendimit në Fletore Zyrtare.

### **Kapitulli 3**

#### **Dispozita të fundit**

#### **Neni 7**

##### **Amendime të Rregullores**

Këto rregulla janë objekt i rishikimit dhe ndryshimit me vendim të Bordit të ERE-s, të propozuara nga OST, në përputhje me Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.

#### **Neni 8**

##### **Hyrja në fuqi**

Këto rregulla hynë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

